



BETO FINISH

Ngjyra	Paketimi	Konsumi
Gri	Thes 20 kg	12-15(kg/m ²)/1mm trashësi



PËRSHKRIM

Stuko patinimi kundra lagështirës me bazë çimento gri, rërë mermeri të cilësisë së lartë, rezina sintetike speciale dhe aditivë specif-ic i përforcuar me bra. Karakterizohet nga një punueshmëri e shkëlqyer, hapje shumë e mirë si në sipërfaqe horizontale ashtu edhe vertikale. Lejohet aplikimi deri në 3-5 mm trashësi për shtresë. Pas fërkimit me letër smerile jep një rifiniturë të lëmuar.

FUSHA E APLIKIMIT

Përdoret për stukimin e mureve dhe tavaneve në sipërfaqet e betonit për ambiente të jashtme dhe të brendshme. Stukoja e patinimit duhet të aplikohet në temperaturë nga +5°C deri në +35°C. Ideal për mbushjen dhe riparimin e sipërfaqeve të betonit me plasaritje të vogla. Për riparimin dhe ristrukturimin e sipërfaqeve të dëmtuara gjatë betonimit. Mbi sipërfaqe betoni me porozitet të lartë, rekomandohet që përpara të aplikohet një primer i përshtatshëm Dekoll.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra, bojra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Nëse suporti ka disnivele të mëdha atëherë duhet të bëhet nivelimi i tij.

PËRGATITJA E PRODUKTIT

Përziejmë 6 – 6.5 l ujë të pastër me 20 kg produkt, masa e krijuar rekomandohet të përziejhet me një përzierës elektrik derisa të formohet një masë homogjene. Masa e krijuar lihet në qetësi për 5 minuta dhe rekomandohet të përziejhet përsëri përpara përdorimit. Aplikoni produktin me një mallë inoksi dhe bëni nivelimin e tij. Produkti aplikohet me dy shtresa. Trashësia maksimale për shtresë është 3-5 mm. Konsumi 1.2 kg /m²/mm trashësi. Kushtet atmosferike ndikojnë në kohën e tharjes së produktit.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja:	Pluhur
Paketimi:	Thasë letre 20kg në paleta me 1080 kg
Ngjyra:	Gri
Kokrrizimi:	< 0.3 mm
Konsumi:	1.2 -1.5 kg/m ² /mm
Magazinimi:	Të ruhet në vënde të thata mbi paleta druri
Koha e magazinimit:	12 muaj nga data e prodhimit
Masa vëllimore në të thatë:	1.3 gr/m ³
Ujë për përzierjen:	6 - 6.5 litra/thes
Trashësia maksimale e aplikimit për shtresë:	5mm
Shtresat e aplikimit:	dy duar
Temperaturat e aplikimit:	nga 5°C deri në 35°C
Koha e pritjes për aplikimin e bojës:	Minimalisht 3 ditë
Rezistenca në shtypje:	≥ 15 N/mm ²
Aftësia ngjithëse në beton (28 ditë):	≥ 1 N/mm ²
Reaksioni ndaj zjarrit:	Klasa A1